

V E N D I M
Nr.773, datë 16.9.1996

PËR DISIPLINËN NË SHËRBIMIN CIVIL

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në republikën e Shqipërisë” me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. TË PËRGJITHSHME

1. QËLLIMI I VENDIMIT

Vendimi për disiplinën në shërbimin civil ka për qëllim përcaktimin e kompetencave për dhënien e masave disiplinore personave ndaj të cilëve merren këto masa, të të drejtave që kanë palët në konflikt dhe procedurave për dhënien e masave disiplinore në shërbimin civil shqiptar. Vendimi synon t’i shërbejë mbrojtjes së personave të punësuar në shërbimin civil nga ndonjë masë e padrejtë që mund të merret ndaj tyre dhe, nga ana tjetër, siguron largimin nga shërbimi civil shqiptar të personave të padenjë për të punuar në të.

2. SHKELJET DISIPLINORE

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 32 të ligjit të shërbimit civil në Republikën e Shqipërisë:

1. Me “Moskryerje të detyrave pa shkaqe të pranueshme dhe sjellje e keqe gjatë kohës së kryerjes së detyrave” kuptohet:

- a) Mosbindja, pa shkaqe të pranueshme, ndaj eprorëve.
- b) Mosrespektimi, pa shkaqe të pranueshme, i orarit të punës.
- c) Mosrespektimi, pa shkaqe të pranueshme, i afateve të caktuara për kryerjen e detyrave.
- d) Sjellja e keqe, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe publikun.

2. Me “Dëmtim pa shkaqe të pranueshme të pronës së shtetit ose krijimi i rrezikut për një dëmtim të tillë” kuptohet:

a) Dëmtimi, pa shkaqe të pranueshme, i pronës ose shërbimeve shtetërore apo përdorimi i saj për veprimtari ose qëllime jo të miratuara zyrtarisht.

b) Krijimi, pa shkaqe të pranueshme, i mundësisë për dëmtim apo keqpërdorim të pronës ose shërbimeve shtetërore.

3. Me “Kryerje e një veprimi pa shkaqe të pranueshme, i cili është në konflikt me rregullat e etikës së shërbimit civil ose që diskrediton një nëpunës civil ose institucion apo shërbim civil, pavarësisht nëse kryhet brenda ose jashtë zyrës” kuptohet:

a) Kryerja, pa shkaqe të pranueshme, e ndonjë veprimi që diskrediton a cenon imazhin e një nëpunësi civil, institucioni të shërbimit civil apo imazhin e nëpunësit dhe shërbimin civil në përgjithësi.

b) Mosrespektimi, pa shkaqe të pranueshme, i detyrave të nëpunësit civil dhe rregullave të etikës së shërbimit civil të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore për etikën në shërbimin civil, në zbatim të këtij ligji.

3. MASA DISIPLINORE

1. Masat disiplinore që jepen sipas shkronjave “b”, “c”, “d” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për shërbimin civil jepen me shkrim dhe vendosen në dosjen personale, duke përshkruar shkeljen disiplinore për të cilën është dhënë.

Masa disiplinore që jepet sipas shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për shërbimin civil jepet gojarisht dhe nuk shënohet në dosjen personale. Ajo ka për qëllim këshillimin ose paralajmërimin për masa të tjera disiplinore në rast përsëritjeje të shkeljes.

2. Largimi nga puna i nëpunësve civilë dhe heqja e së drejtës për të punuar në shërbimin civil jepet sipas shkronjës “e” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për shërbimin civil. Kjo masë shoqërohet me humbjen e statusit të nëpunësit civil dhe e të drejtave që burojnë prej tij. Kjo masë vendoset në dosjen personale, duke përshkruar shkeljen disiplinore për të cilën është dhënë, dhe vihet shënimi përkatës në librezën e punës. Kur jepet kjo masë, njoftohet menjëherë Departamenti i Administratës Publike në përputhje me aktet e tjera nënligjore në fuqi.

3. Masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit mund të rishikohen, me qëllim që të zbuten apo të hiqen si masa disiplinore ose që të hiqen edhe nga dosja personale. Kjo bëhet vetëm nëse nëpunësi nuk kryen shkelje tjetër disiplinore dhe nëse sjellja dhe disiplina e tij kanë një përmirësim të ndjeshëm për një periudhë jo më të vogël se një vit nga dita e fillimit të zbatimit të masës disiplinore.

Rishikimi i masave disiplinore bëhet në çdo kohë, sa herë që bëhet vlerësimi periodik i rezultatit të punës dhe i aftësive personale të nëpunësit.

Masat e mësipërme disiplinore shlyhen në qoftë se brenda tri vjetëve nga dita e dhënies së tyre ndaj nëpunësit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja personale.

4. Zbutja e masës disiplinore ose heqja e saj nga dosja personale propozohet nga “komisioni disiplinor” dhe miratohet nga “organi disiplinor” që do të përshkruhen më poshtë:

4. ORGANET DISIPLINORE

1. Me termin “organ disiplinor” në këtë vendim do të kuptojmë organet që urdhërojnë apo miratojnë marrjen e masave disiplinore.

2. Organet disiplinore, në zbatim të nenit 32, pika 3, të ligjit për shërbimin civil, janë:

Kuvendi Popullor, Presidenti i Republikës, Kryetari i Këshillit të Ministrave, anëtarët e Këshillit të Ministrave, titullarët e institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushtetit lokal dhe titullarët e tjerë të institucioneve të administratës publike.

Këto organe japin masa disiplinore përkatësisht për personat e zgjedhur a të emëruar drejtpërdrejt prej tyre, si dhe për personat që janë punësuar në institucionet ku ata janë titullarë.

Në përgjithësi masa disiplinore propozohet nga organi që propozon emërimin e personit që ngarkohet me përgjegjësi disiplinore dhe miratohet nga organi që i miraton këtë emërim.

3. Në rastet kur personi që ngarkohet me përgjegjësi disiplinor është nëpunës civil, organet disiplinore përkatëse ngarkojnë për shqyrtimin dhe gjykimin e shkeljeve disiplinore një trup gjykues disiplinor, i cili këtej e tutje do të quhet “Komision disiplinor”.

Komisioni disiplinor përbëhet nga këshilli emëruar i institucionit, në të cilin nëpunësi civil është i punësuar. Këshilli emëruar në fjalë është po ai që formohet sipas rregullave të nenit 22 të ligjit për shërbimin civil dhe që në këtë rast paraqitet me atributet e një komisioni disiplinor, me kusht që dy personat që nuk janë të përhershëm, por që caktohen sipas fushës konkrete, për të cilën do të veprohet në rastin konkret, të mbajnë poste që janë në nivele më të larta se sa ai i nëpunësit civil, i cili ka kryer shkeljen disiplinore.

4. Në rastet kur personi që ngarkohet me përgjegjësi disiplinore është funksionar politik, organet disiplinore përkatëse mund t’i delegojnë funksionet e tyre, në përgjithësi, pranë kujtdo që ata e shohin të arsyeshme. Në raste specifike delegimi mund të bëhet te një funksionar politik tjetër ose një grup funksionarësh të emëruar prej organit disiplinor, por:

a) ky grup duhet të ketë një numër tek personash dhe organi disiplinor duhet të emërojë një person si kryetar grupi;

b) çdo person i emëruar duhet të ketë një post të një niveli më të lartë se personi që ngarkohet me përgjegjësi disiplinore;

c) përcaktimi, nëse personi që ngarkohet me përgjegjësi disiplinore është fajtor ose jo dhe vendimi ndaj tij, duhet të konfirmohet nga organi disiplinor përkatës.

5. KËRKESA PËR SHKELJE DISIPLINORE

Kërkesa për fillimin e procedimit për kryerjen e një shkeljeje disiplinore nga ana e një punësi civil duhet t’i drejtohet eprorit të drejtpërdrejtë të këtij nëpunësi, kurse për funksionarin politik duhet t’i drejtohet organit disiplinor përkatës.

Kërkesa duhet:

a) të jetë bërë me shkrim;

b) të identifikojë personin që ngarkohet me përgjegjësi disiplinore;

c) të përcaktojë saktë shkeljen disiplinore, si dhe detajet e rrethanat në të cilat pretendohet se është bërë kjo shkelje.

II. NËPUNËSIT CIVILË

6. PROCEDURAT DISIPLINORE

1. Eprori i drejtpërdrejtë, pasi merr kërkesën dhe kryen veprimet që ai i konsideron të nevojshme për t’u sqaruar rreth saj, vepron në këtë mënyrë:

a) nëse ai mendon se kërkesa nuk ka baza të shëndosha ose mendon se kërkesa është bërë për motive të papranueshme, mund të vendosë që të mos ndërmarrë veprime të mëtejshme, duke informuar në të njëjtën kohë edhe kërkuuesin për vendimin e tij; ose

b) nëse ai mendon se kërkesa është e bazuar, por shkelja nuk është serioze, atëherë mund ta trajtojë çështjen duke dhënë masën disiplinore vërejtje paralajmëruese nëpunësit për masa të tjera disiplinore, nëse ai do të bëjë në të ardhmen shkelje të tjera disiplinore, si dhe t'i japë nëpunësit këshilla për mënyrën se si ai duhet të sillet në të ardhmen gjatë kryerjes së detyrës së tij, ose

c) nëse mendon që kërkesa ka baza të arsyeshme dhe nëse kjo kërkesë përbën një shkelje të rëndë disiplinore ose një vepër penale, duhet të raportojë për këtë problem sa më shpejt që të jetë e mundur me shkrim dhe duke e shoqëruar këtë raport me gjithë informacionin e nevojshëm tek organet disiplinore.

2. Me të marrë një raport mbi një shkelje disiplinore të kryer nga një nëpunës civil, organi disiplinor duhet të bëjë atë hetim që ai e konsideron të nevojshëm, dhe:

a) nëse mendon që kërkesa përbën një vepër penale, duhet të raportojë çështjen në prokurori dhe duhet ta shtyjë marrjen e masës disiplinore deri sa të merret një vendim përfundimtar nga gjykata apo organi kompetent, ose:

b) nëse mendon që kërkesa përbën një shkelje disiplinore aq të rëndë sa për të ndërmarrë masa disiplinore, duhet të fillojë procedurat e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur;

c) nëse ai mendon që kërkesa nuk përbën shkelje të rëndë disiplinore, duhet t'ia referojë çështjen eprorit të drejtpërdrejtë të nëpunësit që ka kryer këtë shkelje, duke i kërkuar atij që çështja të trajtohet me mënyrën e përshkruar në pikën 6.1.b.

3. Në qoftë se organi disiplinor e raporton çështjen në prokurori ose ndërmerr veprime të procedimit, ai duhet ta pezullojë nëpunësin nga kryerja e detyrës së tij, nëse e gjykon këtë në dobi të interesit publik, derisa të merret vendimi përfundimtar.

4. Nëpunësi civil i pezulluar vazhdon të marrë pagën e tij bazë gjatë pezullimit, por organi disiplinor mund të urdhërojë që përfitimet e tjera, që nëpunësi do t'i merrte në kushte normale, të pezullohen. Nëse nëpunësi konsiderohet jofajtor nga organi kompetent ose nga organi disiplinor, të gjitha shumatat që nuk i janë paguar, i kthehen atij menjëherë.

5. Procedurat disiplinore fillohen kur organi disiplinor dërgon një kërkesë me shkrim për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit civil tek kryetari i komisionit.

Kërkesa duhet të përmbajë:

a) emrin e nëpunësit që ngarkohet me përgjegjësi disiplinore;

b) përshkrimin e shkeljes disiplinore që pretendohet se ka ndodhur dhe rrethanat, në të cilat kjo shkelje është kryer;

c) ndonjë dokument me shkrim, nëse organi disiplinor e disponon që dëshmon për këtë shkelje;

d) listë me emrat e personave që mund të dëshmojnë, nëse ka të tillë, duke përfshirë këtu dhe persona që nuk janë nëpunës, për të cilët organi disiplinor mendon se janë të aftë të sjellin fakte rreth kërkesës.

6. Komisioni disiplinor, menjëherë pas fillimit të procedurës disiplinore, duhet t'i dërgojë nëpunësit një kopje të kërkesës dhe ta njoftojë atë me shkrim për sa më poshtë:

a) për pezullimin e mundshëm dhe për mbajtjen e mundshme të ndonjë prej përfitimeve të tij gjatë pezullimit;

b) për të drejtën që ai ka për të bërë një përgjigje me shkrim rreth kërkesës brenda 15 ditësh nga dita e marrjes me shkrim të saj dhe për të sjellë fakte me shkrim, të cilat do të shërbejnë për t'u marrë në konsideratë nga komisioni disiplinor;

c) për të drejtën që ai ka, nëse nuk është dakord me kërkesën që të dëgjohet nga komisioni disiplinor dhe për të paraqitur persona që mund të dëshmojnë, përveç fakteve të shkruara, nëse ka dëshirë ta bëjë një gjë të tillë; dhe

d) për të drejtën e tij që të flasë para komisionit disiplinor jo vetëm personalisht, por edhe nëpërmjet përfaqësuesve, nëse ai e kërkon një gjë të tillë.

7. Në përgjigjen e tij rreth kërkesës nëpunësi mund të kërkojë që çështja të trajtohet mbi bazën e materialeve të shkruara që ai paraqet, ose të vërë në dijeni komisionin disiplinor që ai dëshiron të ushtrojë të drejtat që i jepen në pikat 6.6.c dhe 6.6.d.

8. Kryetari i komisionit disiplinor, në emër të komisionit disiplinor, mund të vendosë nëse

kërkesa e nëpunësit për ta trajtuar problemin mbi bazë të dokumenteve të shkruara do të merret parasysh ose jo. Ai duhet ta vërë në dijeni nëpunësin, me shkrim, për këtë vendim.

Nëse kërkesa e nëpunësit pranohet, në dispozicion të tij duhet të vihen kopje të çdo dokumenti që komisioni disiplinor zotëron dhe që nuk janë në dispozicion të nëpunësit. Ai duhet të ftohet për të bërë ndonjë vërejtje me shkrim rreth këtyre dokumenteve brenda 7 ditëve mbasi i merr ato.

9. Nëse brenda kohës së caktuar në pikën 6.6.b nëpunësi nuk bën dokument me shkrim sipas kësaj pike, ose nuk njofton kryetarin e komisionit disiplinor që ai dëshiron të ushtrojë të drejtat që i jepen nga pika 6.6.c dhe 6.6.d, atëherë komisioni disiplinor mund ta gjykojë çështjen dhe të vendosë pa praninë e nëpunësit.

10. Nëse nëpunësi njofton se nuk është dakord me faktet ose nëse komisioni disiplinor, pasi shqyrton dokumentacionin, mendon se faktet që lidhen me kërkesën kërkojnë hetim të mëtejshëm, atëherë duhet t'i dëgjojë palët për t'i kuptuar më mirë faktet dhe për të zgjidhur konfliktet që mund të lindin prej tyre.

Komisioni disiplinor duhet ta njoftojë nëpunësin për datën, kohën dhe vendin e thirrjes së nëpunësit për t'u dëgjuar dhe për të drejtën që ai ka për të sjellë një përfaqësues, të cilin ai e zgjedh vetë, si dhe për të paraqitur personat që mund të dëshmojnë, të cilët mund të jenë të aftë për të sjellë fakte që lidhen me çështjen.

11. Komisioni disiplinor mund të ftojë persona që mund të dëshmojnë, duke përfshirë këtu edhe persona që nuk janë nëpunës, për të sjellë fakte rreth çështjes. Nëpunësi dhe përfaqësuesi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm, kur këta persona sjellin fakte dhe t'i pyesin lidhur me këto fakte.

Nëpunësi duhet t'i paguajë shpenzimet e personave që mund të dëshmojnë, ai paraqet dhe shpenzimet e përfaqësuesve të tij. Shteti duhet të paguajë shpenzimet e personave që mund të dëshmojnë që thirren nga komisioni disiplinor.

12. Në qoftë se komisioni disiplinor nuk ka kërkuar që ta dëgjojë nëpunësin rreth fakteve, por nëpunësi ka njoftuar komisionin disiplinor se ai dëshiron të flasë para tij, atëherë komisioni disiplinor duhet ta njoftojë nëpunësin për datën, kohën dhe vendin e dëgjimit dhe ta lejojë atë që të flasë vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij.

13. Komisioni disiplinor merr vendimin për dhënien e masës së përshtatshme disiplinore pa praninë e personave të tjerë.

14. Nëse komisioni disiplinor nuk gjen prova për kërkesën, atëherë ai duhet t'ia raportojë këtë gjë organit disiplinor, i cili njofton përsa më sipër nëpunësin me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur.

15. Nëse komisioni disiplinor vëren se shkelja disiplinore është kryer, ai duhet të përcaktojë masën disiplinore të përshtatshme për këtë shkelje, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi, në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë".

Një masë disiplinore do të konsiderohet e përshtatshme vetëm nëse është në proporcion me masën e shkeljes disiplinore dhe me rrethanat, në të cilën kjo shkelje është kryer.

16. Komisioni disiplinor duhet të raportojë tek organi disiplinor vendimin dhe masën disiplinore që ai e ka quajtur të përshtatshme, dhe të japë argumentet përkatëse në mbështetje të tyre.

17. Mbasi merr këtë raport, organi disiplinor mund të marrë vendimet e mëposhtme:

- a) të konfirmojë vendimin dhe masën disiplinore të propozuar;
- b) të konfirmojë vendimin dhe të japë një masë tjetër disiplinore, e cila mund të jetë më e rëndë ose më e lehtë se ajo që ka propozuar komisioni disiplinor;
- c) të mos marrë asnjë masë disiplinore, kur nuk e gjen me vend propozimin e komisionit për fajësinë e nëpunësit.

18. Organet disiplinore duhet të njoftojnë nëpunësin për vendimin, duke dhënë arsyet për marrjen e këtij vendimi dhe afatet kohore të vlefshmërisë së tij. Ky vendim futet në dosjen e nëpunësit. Organet disiplinore duhet të njoftojnë nëpunësin gjithashtu edhe për:

- a) të drejtën që ai ka për të apeluar dhe afatin kohor, brenda të cilit duhet të bëhet ky apel;
- b) datën e fillimit të masës disiplinore.

7. ANKIMI

1. Një nëpunës civil, ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore nga një organ disiplinor, mund të ankohet pranë komisionit të shërbimit civil kundër:

- a) konstatimit të bërë ndaj tij apo vlerësimit të veprimit të tij; ose

- b) masës disiplinore; ose
- c) konstatimit dhe masës së bashku;
- ç) për rastet e tjera të përcaktuara në ligj.

2. Ankimet shqyrtohen nga “Komiteti disiplinor i ankimit”, që ngrihet pranë komisionit të shërbimit civil, i cili përbëhet nga tre anëtarë të komisionit të emëruar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave. Për raste të veçanta Kryetari i Këshillit të Ministrave mund ta ndryshojë përbërjen e këtij komiteti, por gjithmonë kryetari i tij duhet të jetë jurist.

3. Ankimi bëhet nga nëpunësi i interesuar, duke i dërguar një notë me shkrim kryetarit të komisionit të shërbimit civil, në të cilën paraqiten arsyet e ankimit, si dhe dokumentet lidhur me të. Ankimi duhet bërë brenda 15 ditësh, pasi nëpunësi merr njoftimin rreth vendimit të organit disiplinor të institucionit ku ai punon.

4. Nëpunësi mund të kërkojë që ankimi i tij të trajtohet pa u paraqitur për të folur para komitetit disiplinor të ankimit. Në këtë rast kryetari i këtij komiteti duhet të vendosë nëse ankimi do të trajtohet pa e dëgjuar nëpunësin apo duke e dëgjuar atë. Nëse vendoset që nëpunësi duhet dëgjuar, atëherë ky nëpunës duhet që, përveç materialit me shkrim që ka dërguar, të flasë edhe përpara komisionit.

5. Procesi i shqyrtimit të ankimit duhet të fillojë brenda 30 ditëve nga marrja e ankimit.

6. Komiteti disiplinor i ankimit vendos vetë për procedurat që ai do të ndjekë. Në rast se ai do të dëgjojë një raport gojor, atëherë ai duhet të dëgjojë edhe personat që mund të dëshmojnë dhe që mund të thirren nga nëpunësit. Komiteti mund të thërrasë edhe ai persona që sipas mendimit të tij mund të sjellin fakte të nevojshme. Nëpunësi dhe përfaqësuesit e tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë kohës që personat që dëshmojnë flasin dhe t’i bëjnë atyre pyetje rreth dëshmive që ata sjellin.

7. Dëshmia e një personi që mund të dëshmojë, i cili nuk mund të paraqitet, mund të merret edhe me shkrim, por një kopje e kësaj dëshmie i duhet dhënë edhe nëpunësit përpara procesit të dëgjimit. Nëpunësi ka të drejtë të marrë përpara procesit të dëgjimit kopje të çdo dokumenti që do të merret në konsideratë nga komiteti disiplinor i ankimit, duke përfshirë edhe ndonjë pjesë të dosjes së nëpunësit.

8. Në procesin e dëgjimit nëpunësi ka të drejtë të flasë personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej tij.

9. Nëpunësi duhet të paguajë shpenzimet për personat e thirrur prej tij ose prej përfaqësuesit të tij. Shteti duhet të paguajë shpenzimet e personave të thirrur nga komiteti.

10. Komiteti disiplinor i ankimit duhet t’i marrë vendimet e tij pa praninë e personave të tjerë. Vendimet merren me shumicë votash.

11. Komiteti mund të vendosë:

- a) që të pranojë kërkesën dhe masën disiplinore; ose
- b) të pranojë kërkesën, por të marrë një masë më të lehtë disiplinore; ose
- c) të pranojë ankimin dhe të heqë masën disiplinore.

12. Vendimi duhet t’u njoftohet organit disiplinor dhe nëpunësit me shkrim dhe i argumentuar. Nëpunësi duhet të njoftohet për datën e fillimit të veprimit të masës disiplinore. Vendimi futet në dosjen e nëpunësit.

13. Në rastin kur ndaj nëpunësit është dhënë masë disiplinore dhe kur komiteti disiplinor i ankimit e lë në fuqi këtë masë, nëpunësi ka të drejtë të ankohet në gjykatë në bazë të nenit 34 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, dhe sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile

8. ZBATIMI

1. Një vendim për masë disiplinore nuk mund të zbatohet në këto raste:

- a) gjatë periudhës së kohës që nëpunësit i është vënë në dispozicion për t’u ankuar, ose
- b) nëse nëpunësi është ankuar gjatë periudhës së kohës që procesi i ankimit vazhdon dhe data e fillimit të zbatimit të vendimit nuk i është komunikuar nëpunësit nga komiteti disiplinor i ankimit ose nga gjykata.

2. Një nëpunës që është pezulluar nga organi disiplinor, mbetet i pezulluar deri në datën kur ai njoftohet për heqjen e kërkesës ndaj tij, ose për fillimin e zbatimit të masës disiplinore.

III. FUNKSIONET

9. PROCEDURAT DISIPLINORE

1. Nëse organi disiplinor, pranë të cilit paraqitet kërkesa ndaj një funksionari politik, mendon

se kërkesa e paraqitur nuk ka baza të shëndosha ose është bërë për motive të papranueshme, atëherë mund të vendosë që të mos ndërmarrë veprime të mëtejshme.

2. Nëse organi disiplinor mendon se kërkesa mund të qëndrojë, por nuk është dhënë informacioni i mjaftueshëm rreth saj, atëherë ky organ disiplinor mund të ndërmarrë një proces hetimi rreth kërkesës, duke përdorur çdo mjet të ligjshëm që ai e quan të përshtatshëm.

3. Nëse organi disiplinor mendon se kërkesa është e bazuar, ai mund të ndjekë procedurat që i konsideron të përshtatshme për të përcaktuar nëse funksionari politik ka bërë një shkelje disiplinore.

Përpara se të arrijë te ky përcaktim, organi disiplinor duhet:

a) të informojë funksionarin politik me shkrim rreth natyrës së kërkesës dhe rreth rrethanave, në të cilat pretendohet se është kryer shkelja disiplinore, duke përfshirë këtu edhe informacionet që mund të jenë nxjerrë nga ndonjë hetim i bërë;

b) të lejojë funksionarin politik që të mbrohet me shkrim ose me gojë, duke e bërë vetë këtë gjë ose, nëse ai ka dëshirë, nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej tij.

7. Nëse organi disiplinor vërteton se shkelja disiplinore është kryer, por mendon se kjo shkelje nuk është serioze dhe nuk ka nevojë për veprime të karakterit disiplinor, atëherë ky organ duhet të informojë funksionarin politik për sa më sipër dhe të ndërmarrë ato veprime që ai i quan të përshtatshme për t'i kujtuar atij se çfarë kërkohet prej tij gjatë kryerjes së detyrave si funksionar politik.

8. Në qoftë se organi disiplinor vërteton se shkelja disiplinore është kryer nga funksionari politik dhe e quan atë aq serioze sa për të ndërmarrë masa disiplinore, atëherë organi disiplinor mundet:

a) t'i dorëzojë funksionarit politik një masë disiplinore, e cila vendoset gjithashtu edhe në dosjen e tij personale, duke përshkruar shkeljen disiplinore për të cilën është dhënë, ose

b) ta largojë atë nga puna; kjo masë vendoset në dosjen personale, duke përshkruar edhe shkeljen disiplinore për të cilën është dhënë, dhe vihet shënimi përkatës në librezën e punës. Kur jepet kjo masë, njoftohet menjëherë Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me aktet e tjera që lidhen me këtë problem.

Organi disiplinor duhet ta informojë me shkrim funksionarin politik, nëse mendon se ky funksionar është fajtor ose jo, si dhe rreth vendimit të marrë ndaj tij, sa më shpejt që të jetë e mundur.

9. Në qoftë se organi disiplinor mendon se veprimi i funksionarit politik në kryerjen e shkeljes disiplinore përbën një vepër penale, ai duhet t'ia raportojë këtë çështje prokurorisë.

10. ANKIMI

1. Nëse ndaj funksionarit politik merret masa e përshkruar në pikën 9.8.a, atëherë ai nuk ka të drejtën e ankimit.

2. Nëse funksionari politik nuk e ka gëzuar statusin e nëpunësit civil para se të emërohej si funksionar politik dhe ndaj tij merret masa e përshkruar në pikën 9.8.b, atëherë ai nuk e ka të drejtën e ankimit.

3. Nëse funksionari politik ka gëzuar statusin e nëpunësit civil para se të emërohej si funksionar politik dhe ndaj tij merret masa e përshkruar në pikën 9.8.b, ai nuk ka të drejtë të ankohet për t'u kthyer në punë si funksionar politik, por mund të ankohet pranë komitetit disiplinor të ankimit njëlloj si një nëpunës civil, ndaj të cilit organi disiplinor ka dhënë masën e largimit nga puna.

4. Komiteti disiplinor i ankimit vepron sipas pikës 7 të këtij vendimi, duke e konsideruar ankuesin si një nëpunës të atij niveli që ai kishte para se të emërohej si funksionar politik.

5. Nëse komiteti disiplinor i ankimit hedh poshtë masën e largimit nga puna, atëherë me nëpunësin veprohet njëlloj si me funksionarët politikë që rikthehen në shërbimin civil, pasi u ka mbaruar afati i shërbimit si funksionarë politikë.

6. Nëse komiteti disiplinor i ankimit pranon kërkesën, por jep një masë më të lehtë disiplinore, atëherë ankuesi rikthehet në shërbimin civil njëlloj si në pikën 10.5, por i shoqëruar nga masa disiplinore e dhënë prej komitetit disiplinor të ankimit.

II. ZBATIMI

1. Vendimi për largimin nga puna i funksionarëve politikë zbatohet brenda afatit që vendos organi disiplinor përkatës.

2. Funksionarët politikë që kanë të drejtën e ankimit, trajtohen njëlloj si nëpunësit civilë të

pezulluar nga puna, ndaj të cilëve organi disiplinor përkatës ka dhënë masën e largimit nga puna.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi